



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
*Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore*  
**KRYETARI**

Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1,

[www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al) E-mail: [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)

Nr. 1011/8 Prot.

Tiranë, më 30/11/ 2018

**V E N D I M**

**Nr.173, Datë 30 / 11 / 2018**

**PËR**

**AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË BORDIN E UJITJES DHE KULLIMIT DURRËS  
ME OBJEKT: "AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE", PËR PERIUdhËN 01.01.2017 DERI MË  
DATËN 31.08.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Bordin e Ujitjes dhe Kullimit Durrës, me objekt "Auditim Përputhshmërie", për periudhën 01.01.2017 deri në 31.08.2017, u konstatuan devijime nga rregullat e prokurimit publike, të rëndësisë materiale për të cilën japim opinion të kualifikuar.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të ushtruar në Bordin e Ujitjes dhe Kullimit Durrës, me objekt "Auditim Përputhshmërie", sipas programit të auditimit nr.1011/1 datë 07.09.2018, për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.08.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përmirësimit e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

**I. OPINIONI I AUDITIMIT:**

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Bordit të Ujitjes dhe Kullimit Durrës është mbështetur në: ligjin nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së; Standardet Ndërkombëtare të auditimit "ISSAI 400"; Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatueshmerisë nga subjekti Bordit të Ujitjes dhe Kullimit Durrës të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri rregullator (kriteret), që zbaton Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Durrës për prokurimet publike, të cilat janë materiale dhe jo të përhapura dhe kryesisht konsistojnë në, parregullsi në përzgjedhjen e procedurave të prokurimit "me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës", në përllogaritjen më tepër të fondit limiti në vlerën 532,533 lekë dhe në vlerësimin e ofertave, me efekt që ndikon në rritje të kostos së objektit në vlerën 10,393,474 lekë

#### **Përgjegjësit e audituesit janë:**

Grupi i auditimit ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs) dhe konkretisht ISSAI 4000 "*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*". Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë*", pjesë e raportit tonë (faqja 4). Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura me siguri të arsyeshme, por nuk garantojmë që auditimi i kryer në përputhje me këto standarde mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mundë të ekzistojë. Gjithashtu, besojmë se, dëshmitë dhe evidencat e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat e arsyeshme për arritjen në opinionin e auditimit.

#### **Opinionin e auditimit:**

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Bordit të Ujitjes dhe Kullimit Durrës, u konstatuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë materiale dhe jo të përhapura, për të cilën **japim opinionin të kualifikuar**<sup>1</sup>.

## **II. GJETJE DHE REKOMANDIME**

### **A. REKOMANDIME PËR MASA ORGANIZATIVE**

Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Durrës (BUKD), për vitin 2017 ka realizuar 13 procedura prokurimi me fond limit në vlerë prej 193, 400, 317 lekë, dhe ka lidhur 13 kontrata me vlerë prej 228,433,041 lekë dhe për vitin 2018 ka realizuar 16 procedura prokurimi me fond limit në vlerën prej 169, 081, 378 lekë dhe ka lidhur po 16 kontrata me vlerë prej 160,170,969 lekë. Nga auditimi këtyre procedurave në përgjithësi nuk u konstatuan shkelje të qenësishme në lidhje me keqpërdorimet e fondeve publike, por në disa procedura të veçanta u konstatuan edhe devijime nga kuadri rregullator i prokurimeve publike, si më poshtë:

**1. Gjetje.** Në mbështetje të nenin 33, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" dhe të nenit 36, të VKM, nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",

<sup>1</sup> Sipas *Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë* të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

BUKD ka realizuar disa procedura prokurimi “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”. Për zhvillimin e këtyre procedurave është marrë miratim paraprak nga Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Por, në zbatim të nenit 60 të VKM nr. 914, datë 20.12.2014, BUKD duhet të bënte përpjekje dhe të insistonte duke filluar që me hartimin e projekteve të zbatimit për ti kërkuar MBZHRAU financimin e këtyre objekteve, dhe që në momentin e miratimit të ligjit të buxhetit të shtetit në muajin dhjetor 2016 do të krijoheshin kushtet për fillimin e menjëhershëm të procedurave të “Hapur” dhe në këtë mënyrë do të shmangeshin procedurat “me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës. Konkretisht, janë zhvilluar këto procedura me negociim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës:

- Procedura e prokurimit me objekt: “Pastrim i përroit të Draçit (Faza e parë)”, me fond limit në vlerën 63,444,985 lekë, të realizuar, në vitin 2017;
- Procedura e prokurimit me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve të objektit “Pastrim i përroit të Draçit (Faza e parë)” me fond limit në vlerën 1,370,412 lekë, të realizuar, në vitin 2017;
- Në procedurën e prokurimit me objekt: “KLU – 1, Kanali Peqin – Kavaje ( Lumi Shkumbin) (rehabilitim)”, me fond limit në vlerën 65,449,333 lekë të realizuar, në vitin 2017;
- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve në objektin KLU – 1, Kanali Peqin – Kavaje ( Lumi Shkumbin) (rehabilitim)” me fond limit në vlerën 1,217,333 lekë, të realizuar, në vitin 2017;
- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Argjinatura e Lumit Drini i Zi fshati Potgorce (vazhdim)” të realizuar në vitin 2017 me fond limit në vlerën 21,960,000 lekë të realizuar, në vitin 2017;
- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Mbikëqyrje e punimeve në objektin Argjinatura e Lumit Drini i Zi Potgorce ( vazhdim)” me fond limit në vlerën 540.000 lekë të realizuar, në vitin 2017 (*Më hollësisht, trajtuar në faqet 3-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **1.1.Rekomandimi:**

Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Durrës, për çdo fund viti, që me miratimin e ligjit për buxhetin e shtetit, nëse janë planifikuar fonde, për çdo procedurë prokurimi duhet ti referohet nenit 60 të VKM nr. 914, datë 20.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim eliminimin e përdorimit të procedurës “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”. Për çdo rast përdorimi të kësaj procedure, duhet të dokumentohet dhe të argumentohet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 33, të Ligjit nr. 9 643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe neni 36, të VKM nr. 914, datë 20.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe të merret miratim nga Agjencia e Prokurimit Publik dhe Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

### **Në vijimësi**

**1.2. Gjetje.** Në procedurën e prokurimit me objekt “Menaxhim ujitje në KU Kavajë-Klos” me fond limit 3.333.333 lekë, e zhvilluar “Kërkesë për propozim”, në vitin 2018. Llogaritja e fondit limit është bërë duke marrë për bazë 22 punonjës që do të punojnë për mirëmbajtje, me pagë 28,008 lekë/muaj dhe kohen e vaditjes me afat prej 5 muaj. Sipas kësaj llogaritje fondi limit është 3,080,880 lekë (22 \* 5\* 28,008 lekë). Ndërsa Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar fondin limit në vlerën prej 3,333,333 lekë, ose më tepër 252,453 lekë. Kjo procedure është anuluar njëherë dhe është zhvilluar përsëri me urdhrin nr. 10 datë 02.05.2018 me fond limit në të njëjtën vlerë sa ishte në procedurën e parë prej 3,333,333 lekë. Por në këtë procedurë të dytë ka ndryshuar numri i punëtorëve dhe afati i shërbimit. Konkretisht, nga 22 punonjës është bërë 25 punonjës, ndërsa afati nga 5 muaj është bërë 4 muaj. Sipas këtyre ndryshimeve fondi limit duhej të përcaktohej në vlerën prej 2,800,800 lekë (24\*4\*28,008). Pra, fondi limit është rritur artificialisht më tepër për shumën prej 532,533 lekë. Në përfundim të tenderit është shpallur fituese shoqëria “G...” me ofertë në vlerën 2,800,800 lekë. Ndonëse fondi limit është llogaritur artificialisht më tepër për shumën 532,533 lekë, nga auditimi

rezultoi se, nuk është shkaktuar dëm ekonomik, pasi kontrata e lidhur është në vlerën 2,800,800 lekë, pra e barabartë me vlerën e fondit limit të llogaritur nga auditimi (*Më hollësisht, trajtuar në faqet 3-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **2.1. Rekomandimi:**

Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Durrës, për çdo procedurë prokurimi që do të realizojë fondin limit ta llogaris, ta argumentoi dhe ta dokumentoi sipas kërkesave të kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

### **Në vijimësi**

**3. Gjetje.** Në procedurën e prokurimi me objekt “Mbrojtje nga lumi Drini i Zi, fshati Brezhdan” me fond limit në vlerën 36,913,754 leke, me procedurë prokurimi të “Hapur”, të realizuar në vitin 2018, kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik. KVO ka kualifikuar “E..” se, plotësonte të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta dhe më pas e ka shpallur fitues me vlerë oferte 36,593,665 lekë. Ndërsa ka s`kualifikuar dy operatorin tjetër të cilët kanë paraqitur ofertat me të ultë se, operatori i kualifikuar dhe i shpallur fitues. Konkretisht, operatorin “N.....” me ofertë më të ulët se, fituesi me diference në vlerën 13,647,363 leke. Ky operator është s`kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit publik, sepse në kundërshtim me nenin 74 pika 2 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nuk ka paraqitur Akt–Marrëveshjen dhe Prokurën e Posaçme për këtë Bashkim e kësaj shoqërie. Ndërsa operatorin tjetër “E....” i cili ka paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 27,932,436 lekë ose më të ulët se fituesi me diferencë në vlerën 8,661,229 lekë pa TVSH, e ka skualifikuar për këto arsye:

-Kjo shoqëri në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të kërkuara në DT, nuk ka paraqitur, shtojcën nr. 11 “Deklarate mbi kontratat e lidhura apo në proces” dhe shtojcën nr. 8 “Deklarate mbi përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme” të kërkuara në DT në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”.

Edhe pse, ky operator nuk ka paraqitur këto kërkesa të vendosura në DT, KVO nisur nga oferta ekonomike më e ulët, referuar pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, këto mungesa, mundë ti konsiderohente devijime të vogla, me arsyetimin e thjeshtë se, ato nuk e pengonin operatorin për të ekzekutuar me sukses këtë kontratë. Për më tepër përmbushja e Kritereve të Përgjithshme vërtetohet lehtësisht sepse ky operator ka hedhur në sistem elektronik të gjithë dokumentacionin që përmbush kriteret e përgjithshme. Po kështu ka hedhur në sistem të gjitha licencat profesionale të cilat janë në vlerat mbi limitet maksimale të punëve që mundë të kruhej, pra vërtetohet lehtësisht se, ky operatore ka kapacitet tekniko profesional të ekzekutoj me sukses këtë kontratë, edhe nëse ka njëkohësisht kontrata të tjera në proces (*Më hollësisht, trajtuar në faqet 3-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Rekomandimi:**

**3.1.** Bordi i Ujitjes dhe Kullimit Durrës, në çdo procedurë prokurimi për mallra,shërbime dhe punë në rastet kur konstatohen mangësi në dokumentacionin teknik të operatoreve pjesëmarrës, ti kërkohet këtyre operatorëve sqarime për mangësitë e konstatuara, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”.

### **Në vijimësi**

**3.2.** Të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për rritjen e kostove buxhetore në shumën 10,393,474 lekë, me TVSH. Kjo vlerë është llogaritur si

diferencë e ofertes ekonomike të operatorit fitues me ofertën ekonomike të operatorit s`kualifikuar "EGLAND& BE-IS" (36,593,665 lekë- 27,932,436 x 20%).

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE**

**Gjetje.** Nga auditimi i dosjes teknike të azhurnimit topografik, librezës së masave dhe situacionit përfundimtar të objektit "*Rehabilitimi i kanalit kryesor Ujitës Peqin-Kavajë*", me vlerë 78,435,702 lekë me TVSH me sipërmarrës operatorit ekonomik "A....." u konstatua pasaktësi në llogaritjen e volumeve të transportit të dherave për zërat e gërmimit të cilat shkarkohen në mjet. Konkretisht, zëri nr. 8 në librezën e masave është llogaritur në sasinë prej 5,347.8 m<sup>3</sup> dhe zëri nr. 10 është llogaritur në sasinë prej 15,203 m<sup>3</sup>, pra në total në sasinë prej 20,550.8 m<sup>3</sup>. Në situacionin përfundimtar zëri nr. 8 është likuiduar në sasinë prej 5,248.41 m<sup>3</sup> dhe në fondin rezervë 99.78 m<sup>3</sup>, pra në total 5,348 m<sup>3</sup> e njëjtë si në llogaritjet në librezën e masave. Zëri nr. 10 është likuiduar në sasinë prej 14,203.4 m<sup>3</sup> dhe në fondin rezervë 1000 m<sup>3</sup>, pra në total 15,203 m<sup>3</sup> e njëjtë si në llogaritjet në librezën e masave. Ndërkohë, zëri i transportit të dherave në situacionin përfundimtar është likuiduar në sasinë prej 17,400.2 m<sup>3</sup> dhe në fondin rezervë në sasinë prej 5002 m<sup>3</sup>, pra në total 22,402.2 m<sup>3</sup>. Rrjedhimisht sasia prej 1,851.4 m<sup>3</sup> me çmimin përkatës prej 250 lekë/m<sup>3</sup>, me vlerë 555,420 lekë me TVSH, nuk rakordon me dokumentacionin teknik të sipërcituar (*Më hollësisht, trajtuar në faqet 3-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Rekomandimi:**

Bordi Rajonal i Kullimit Durrës të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet ekonomikitet **të vlerës 555,420 lekë**, e cila nuk justifikohet me dokumentacion teknik nga sipërmarrësi i punimeve.

**Menjëherë**

## **C. MASA DISIPLINORE E ADMINSTRATIVE**

Drejtori i Bordit të Ujitjes dhe Kullimit, të vlerësojë, dhe analizojë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës, duke marrë masat përkatëse për mangësitë e konstatuara në zbatimin e ligjshmërisë së prokurimeve publike, të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.*

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**

**Grupi i Auditimit**

Bashkim Arizaj

Andrea Kristo

Valentina Sulo

Aldo Kume